



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	04.06.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – MAJ 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUdhËN RAPORTUESE 01.05.2025-31.05.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit maj 2025-janë pranuar gjithsejtë 74-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 22 lëndë, që në total rezulton të jenë 96 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 61 kërkesa, 38 të miratuara, 17 të refuzuara, 5 të ceduara dhe 1 kërkesë është pezulluar. Në kuadër të statistikave për lëndët e bartuara për muajin vijues perfshihet edhe lënda e pezulluar.

Për shqyrtim në muajin vijues barten 36 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Gjatë muajit maj 2025 janë lëshuar 17 konkluzione si në vijim:

1. Konkluzion për taksë për leje ndërtimore – 5;
2. Konkluzion për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore 5;
3. Konkluzion për leje mjedisore komunale – 2
4. Konkluzion për leje rrënimi – 2.
5. Konkluzion për legalizim -1.

Gjithsejtë 15 konkluzione për kategori të ndryshme të të hyrave

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

1. Procesi i trajtimit të çështjes së themelimit dhe funksionalitetit të Këshillave të banimit në ndërtesat e banimit të përbashkët – dy takime me qytetarë;
2. Fillimi i procesit të identifikimit të ndërtesave me materiale asbesti;
3. Hartimi i disa disa detyra projektuese për hartimin e projekteve zbatuese sipas kërkesave të drejtorateve të tjera;
4. Puna në raportin e përformancës;
5. Është punuar në kuadër të Komisionit për vlerësimin e pronave komunale;
6. Është përgatitur dokumentacioni për pagesen e operatorëve për hartimin e projekteve.

Në kuadër të trajtimit të kërkesave, janë shqyrtuar edhe plotësimet e dokumentacionit të cilat i kanë parashtruar palët bazuar në ftesat e dërguara nga DPUMM për shkak se kërkesat ishin të pakompletuara.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

Çështja e funksionalitetit të Këshillave të banimit.

Vazhdimi i punës në identifikimin e ndërtesave me materiale asbesti.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezulluar	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	13	2	4		2		9
2.	Leje ndërtimi	15	7	6		5 ¹		11
3.	Leje rrënimi	3	1	2		1		1
4.	Certifikatë përdorimi		1		1			1
6.	Pëlqime parimore për solar	1		1				
7.	Akte nga MMPHI me efekte juridike		2	1				1
13.	Informacione urbane	6		5				1
14.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	5	1	2		1		3
15.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
16.	Tërheqje e lëndës dhe vendimi për pushimin e procedurës	2	1	3				
17.	Bashkim/ndarje e parcelave	8	2	6		1	1	2
18.	Shndërrim toke nga bujqësore në ndërtimore		1			1		
19.	Ankesa	4				1 ²	3	
21.	Kërkesë për vazhdimin e kushteve ndërtimore	2		1				1
23.	Dëshmi për Cer. Përdor.	1		1				
24.	Kërkesë për LMK	8	4	2		4 ³		6
25.	Emërtim rruge	1					1	
26.	Detyra për hartim të projekteve	4		4				
32.	Nderrim destimi i ndërt.	1				1		
	Gjithsejtë:	74	22	38	1	17	5	36

¹ Për njëren kërkesë është lëshuar vetëm njoftim.

² Është njoftuar pala lidhur me adresimin e gabuar.

³ Për njëren kërkesë është lëshuar vetëm njoftim.

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e ndërtimit</i>	<i>Sipërf. Tokës -m2</i>	<i>Sip.nderësës- m2</i>	<i>Destinimi</i>	<i>Vendi</i>
1.	II	5964	1158.19-afariste 5744.48- banim	NL- B	Lipjan
2.	II	62991	23659.13	Afariste	Konjuh/ Babush
3.	I	400	297.78	Banim	Lipjan
Gjithsejtë		69355	30859.58		

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit maj 2025 kemi pasur dy diskutime publike lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e Këshillave të banimit.

SFIDAT:

- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;
- Konkursset për plotësimin e vendeve të lira të punës ende nuk kanë dhënë rezultate.

BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë këtij muaji janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....108,499.81€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:69,238.75€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej..... 11.686.40€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:..... ..279.44€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej338.15€

Shuma totale e të hyrave:190,042.55€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin maj 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.